

Bazuar në nenin 22 paragrafin 1 paragrafin 6 dhe paragrafin 8 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 27/16 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" 143/19 dhe 14/20), nenin 22 paragrafin 1 alineën 1 të Ligjit për marrëdhëniet e punës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 149/09 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16, 120/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" 110/19, 267/2020, 151/2021 dhe 288/2021), Ministria e Mjedisitn Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Maqedonisë së Veriut njofton:

SHPALLJE PUBLIKE

NUMËR 4/2023

për punësimin e 1 (një) këshilltarit të posaçëm në zyrën e ministrit të Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor për një kohë të caktuar

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor publikon shpallje për punësimin e 1 personit në kohë të caktuar, deri në përfundim të mandatit të ministrit, në pozitën si në vijim:

1. Këshilltar special për koordinim të projekteve - 1 përmbaarues;

Kualifikimet e nevojshme:

- Niveli i kualifikimit VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredite të fituara sipas EKTS ose shkallës së përfunduar VII/1; Fakulteti i Teknologjisë dhe Metalurgjisë;
- njohuri aktive e njërës prej tre gjuhëve më të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- Njohuri aktive të programeve kompjuterike, përvojë pune në punë me projekte dhe përpunimin e informacionit dhe bazave të të dhënave konsiderohet përparësi.

Krahas kualifikimeve të kërkuara të lartpërmendura, kandidati duhet të plotësojë këto kushte të përgjithshme:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut
- të përdorin në mënyrë aktive gjuhën maqedonase
- të jetë në moshë të plotë
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës
- me aktgjykim të formës së prerë nuk është dënuar me ndalim të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Orari i punës nga ora 8:30 deri në 16:30, pra 40 orë në javë;

paga neto: 50.000,00 denarë.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- letër motivuese,
- biografi e shkurtër,
- kopje e certifikatës së shtetësisë,
- kopje të diplomës universitare,
- si dhe diploma dhe certifikata të tjera që posedojnë dhe janë relevante për pozicionin.

Dokumentacioni i nevojshëm duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur direkt në Arkivin e Ministrisë së Mjedisit jetësor dhe Planifikimit Hapësinor ose me postë në adresën e mëposhtme:

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
Bul. "Presveta Bogorodica" nr.3 Kabineti i ministrit
(me shenjën "për shpallje punësimi")

Afati për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm është tre (3) ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Aplikimi dhe dokumentacioni i vonuar dhe i pakompletuar nuk do të merren parasysh. Pas përzgjedhjes së kandidatëve të regjistruar për të plotësuar pozitën e specifikuar, kandidatët e përzgjedhur do të thirren në intervistë shtesë në ambientet e Ministrisë. Ministria do të bëjë zgjedhje brenda afatit të paraparë në pajtim me nenin 23 paragrafit 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Punës.

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor